



Kosovo Local Government Institute
Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale
Kosovski Institut za Lokalnu Samoupravu

Analizë

PASQYRIM I PËRBËRJES SË KUVENDEVE KOMUNALE

- Hulumtim mbi Kuvendet Komunale në Kosovë -

PRISHTINË, 2022

The activity was implemented in the framework of the program 'Dialogue for European Municipalities' (DEM), supported by the Norwegian Embassy in Pristina



Norwegian Embassy

DEM
Dialogue for European Municipalities

Përmbajtja:

Hyrje.....	3
Konteksti	3
Metodologjia.....	4
Mjedisi politik dhe institucional i funksionimit të Kuvendeve Komunale	5
Kategorizimi i Komunave sipas numrit banorëve të reflektuar në numrin e anëtarëve	6
Përfaqësimi i të rinjve në Kuvendet Komunale.....	1
Përfaqësimi i këshilltarëve të kuvendit komunal me mandat të parë	3
Përfaqësimi i grave në kuvendin komunal	7
Konkluzionet:.....	10
Rekomandimet:	11

Hyrje

Ky dokument pasqyron përbërjen, strukturën e Kuvendeve Komunale në komunitet e Republikës së Kosovës në mandatin 2021-2025. Nga të dhënat e qasshme të siguruara në analizë janë përfshirë **38** Komuna. Analiza shtrihet në dy dimensione kyçe: e para, trajton mjedisin politik, institucional si dhe të funksionimit të Kuvendeve Komunale; dhe e dyta, analizon, krahason aspekte kuantitative, ndër mandate dhe mes dy mandateve **2017 – 2021**, duke reflektuar ndryshimet në moshë, në ri-zgjedhje (mandatarët e rinj), si dhe pasqyrimin në aspektin gjinor. Përzgjedhja e këtyre çështjeve për analizë, për nga rëndësia vlerësohet kyçe për funksionimin e politikbërjes dhe vendimmarrjes në qeverisje lokale. Kuvendi Komunal përfaqëson organin më të lartë¹ vendimmarrës të një komune, me anetarët e Kuvendit Komunal të përzgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët. Kategorizimi i Kuvendeve Komunale reflekton numrin e anëtarëve të Kuvendit Komunal, duke u bazuar në numrin e banorëve të asaj komune².

Dokumenti ka pesë (5), kapituj: i. konteksti; ii. Mjedi politik dhe institucional i funksionimit; iii. Kuvendi dhe trupat e tij; iv. Pasqyrimin në numra; v. Konkluzionet dhe rekomandimet. Analiza është shtrirë në dy rrafshë: pasqyrimin e të gjeturave nga raportet kredibile, vendore, ndërkombëtare si dhe dokumentet, politikat në këtë fushë. Në mbledhjen, konfirmimin e të dhënave janë konsultuar administratat e kuvendeve komunale, si dhe direkt mbi tetëqind (800) këshilltarë komunalë.

Në analizë janë përfshirë çështje të ngritura përgjatë diskutimeve, punëtorive dhe programeve trajnuese. Të dhënat janë kryqëzuar me letërnjoftimin e komunave, raportet e rregullta të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe informacione tjera relevante. Ky dokument, mund t'u shërbejë akterëve që merren me qeverisjen lokale, organizatave vendore dhe ndërkombëtare, politikbërësve dhe vendimmarrësve.

Konteksti

Republika e Kosovës në vitin 2008 ka miratuar një pako të gjerë Ligjore të organizimit, funksionimit dhe financimit të qeverisjes lokale. Para vitit 2009, mandati 2009-2013 është paraprirë nga Rregullorja për Vetëqeverisjen Lokale e UNMIK, 2007/30 për themelimin e fushës ekzekutive në Komuna. Përderisa, rregullorja 2000/45, ka paraparë organin e vetëm Kuvendin Komunal të përfaqësuar nga kryetari. Me miratimin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, 03/L-40, të vitit 2008, procesi rriti kredencialet demokratike, duke zgjedhur me votë të drejtpërdrejt Kryetarin e Komunës dhe përfaqësuesit në Kuvendin Komunal. Njëkohësisht, ligji ka paraparë detyrat dhe përgjegjësitë e ndara, duke i dhënë rol të rëndësishëm ekzekutiv komunal në menaxhimin e çështjeve publike, ndërkaq kuvendit rolin e përcaktuar në hartimin e politikave, rregullativës dhe atë mbikëqyrës.

¹ Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Kreu VI, neni 35, pika 35.1

² Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Kreu VI, neni 36, pika 36.1 shkronat (a – g) dhe 36.2

Përderisa Ligji për Zgjedhjet Lokale përcakton mënyrën e zgjedhjes, llogaritjen dhe ndarjen e mandateve dhe barazinë gjinore, Ligji për Vetëqeverisje Lokale përcakton rolin e Kuvendeve Komunale, numrin e anëtarëve sipas banorëve, mandatin, konfliktin e interesit, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Kuvendit Komunal, mënyrën e zgjedhjes së kryesuesit, formën e funksionimit, si dhe trupat e kuvendit. Po ashtu, në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale përcaktohen funksionet e Kuvendit të Komunës, përgjegjësitë që mund t'i delegojë dhe ato që nuk mund t'i bartë. Përveç tjerash, ky ligj përfshin një seri mekanizmesh që mundësojnë mbikëqyrjen dhe llogaridhënien efektive të ekzekutivit karshi Kuvendit Komunal.

Metodologjia

Qëllimi i këtij hulumtimi është analiza e përbërjes së Kuvendeve Komunale në Kosovë, duke marrë parasysh disa faktorë: moshën, mandatin dhe gjininë. Megjithatë, ky hulumtim si faktor kontribuues ka përfshirë edhe ndryshimet në Kuvendet Komunale, duke krahasuar numrin e mandateve për 28 komuna me **(819 anëtarë)** nga 38 komuna me total **(1002 anëtarë)**, të dhëna këto të përpunuara nga instituti KLGJ. Janë analizuar dhe krahasuar të dhënat nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) për rezultatet e dy periudhave zgjedhore (2017 dhe 2021), të reflektuara në përqindje të ndryshimit mes dy mandateve në përfaqësim (strukturë të Kuvendeve Komunale). Të dhëna specifike sikur mosha janë konfirmuar nga **917 prej 1002³**, këshilltarëve komunalë në **28 nga 38 komuna**. Të dhënat janë siguruar nëpërmjet komunikimit me administratat komunale apo direkt nga këshilltarët komunalë. Të gjitha të dhënat janë dokumentuar për analizë të mëtutjeshme.

Për secilën komunë është paraqitur numri i përgjithshëm i këshilltarëve komunalë dhe janë ndarë në bazë të kategorive për analizë. Në fokus kanë qenë anëtarët e Kuvendit Komunal me moshë nën 30 vjeç; mandati i parë i këshilltarëve komunalë dhe përfaqësimi sipas gjinisë. Në bazë të të dhënave janë nxjerrë përqindjet për secilën kategori. Të dhënat e përgjithshme janë kalkuluar për 38 komuna, përveç moshës së këshilltarëve në 28 nga 38 komuna dhe numrit të përgjithshëm të mandateve. Secili është analizuar në varësi të tabelave sipas komunave veç e veç, apo si tërësi. Rezultatet janë të reflektuara në numra dhe përqindje.

³ <https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2021/11/03.-Rezultatet-e-subjekteve-dhe-ndarja-e-mandateve.pdf>

Mjedisi politik dhe institucional i funksionimit të Kuvendeve Komunale

Sistemi aktual i zgjedhjeve lokale vlerësohet se paraqet kredenciale të larta demokratike, megjithatë sfidë ende mbeten komunikimi dhe bashkëpunimi brenda komunal, në veçanti në tri (3) segmente (Kuvendi – Kryetari – Administrata Komunale). Raporti i Progresit për Kosovën (2020), nxjerr në pah mungesën e kontrollit dhe balancave të pushteteve dhe ndikimin politik mbi administratën, duke theksuar se ‘Asambletë komunale kanë kompetenca të kufizuara efektive buxhetore dhe ushtrojnë mbikëqyrje të pamjaftueshme mbi administratat komunale, ndërsa ndikimi i tepruar politik mbi administratat lokale dobëson qeverisjen lokale’⁴. Përderisa vihet re se bashkëpunimi midis shoqërisë civile dhe qeverisë në nivelin qendror po përmirësohet, në nivelin lokal theksohet se nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar angazhim dhe bashkëpunim të plotë. Kjo, tregon që edhe kërkesa për llogaridhënie efektive nga shoqëria civile, mbetet e mangët. Për më tepër, vlen të theksohet se nuk ka ekuilibër midis institucioneve brenda komunale.

Për vite, kemi qenë dëshmitarë se marrëdhëniet ndërmjet Kuvendeve Komunale dhe kryetarëve nuk pasqyrojnë mjaftueshëm nevojën për një qeverisje të mirë, efikase dhe demokratike. Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026, në kontekstin e problemeve, tek pjesa organizative thekson se ‘procesi i komunikimit, i bashkërendimit dhe i bashkëpunimit të brendshëm dhe i atij të jashtëm, e sidomos, koordinimi ndër-institucional është përcjellë me mangësi të theksuara gjatë periudhës së kaluar’⁵.

Raporti i Progresit për Kosovën (2019) thekson se ‘megjithëse pushteteve lokale u janë dhënë më shumë kompetenca, burimet e tyre njerëzore dhe financiare shpesh janë të pamjaftueshme. Kapacitetet e kufizuara dhe vështirësitë në zbatimin e ligjeve, rregulloreve, politikave dhe procedurave e dëmtojnë cilësinë e ofrimit të shërbimeve komunale’⁶. Në Strategjinë për VQL (2016-2026), theksohet se ‘në vitet në vijim agjenda legjislative fokusin kryesor do ta ketë në vlerësimin dhe harmonizimin e legjislacionit ekzistues’⁷. Komunitat shpesh ballafaqohen me obligime që dalin nga ky legjislacion, e që në procesin e zbatimit dhe raportimit kufizohen nga kapacitetet e limituara financiare, profesionale, teknike dhe operacionale.

Në veçanti, ky hendek rritet tek Kuvendet Komunale, ku në mungesë të koordinimit me administratat komunale, kufizimeve, mos kontraktimit të ekspertizës, si dhe mos konsolidimit të trupave të Kuvendit (komiteteve sektoriale profesionale si dhe komiteteve konsultative), shpesh vendimmarrja është e pa informuar, pa ekspertizë të mjaftueshme dhe e shtyrë nga interesat e përkatësive politike (partive), të cilat qojnë në mos harmonizim me legjislacionin, qasje ad-hoc si dhe frenojnë politikat e integruara dhe zhvillimore.

⁴ Raporti i Progresit për Kosovën (2020)

⁵ Strategjia për Vetëqeverisjes Lokale (2016-2026)

⁶ Raporti i Progresit për Kosovën (2019)

⁷ Po aty

Nga 38 Komunat e Kosovës, nuk ekziston ndonjë praktikë, ku grupeve politike u është ofruar asistencë, qoftë teknike, financiare apo profesionale. Madje, kjo bëhet edhe më e vështirë, kur kemi parasysh se **502**, (apo 61.29%) **nga 819** anëtarë të Kuvendeve Komunale në 28 komunat e analizuar kanë mandatin e parë në Kuvendin Komunal. Kjo edhe për faktin se viti 2022, përkon me periudhën e hartimit dhe miratimit të dy prej dokumenteve kyçe komunale si: Planet Zhvillimore Komunale dhe Hartat Zonale. Me mungesat e theksuara, rrezikohet që të prodhohen politika jo të qëndrueshme të një (1) dekade. Këto reflektohen në tërë procesin, nisur nga hartimi i politikave/rregullativës, kornizave afatmesme buxhetore (KAB) dhe buxhetet vjetore.

Nuk ekziston ndonjë praktikë e konsoliduar as në hartimin, financimin e programeve për ngritjen e kapaciteteve nga komunat për anëtarët e Kuvendeve Komunale. Shumica e trajnimeve, punëtori, diskutimeve janë të shkurtra në kohë, të pamjaftueshme dhe ofrohen nga Asociacionet dhe organizatat me mbështetjen e donatorëve. Kompensimi mbetet tejet i ulët, si rrjedhojë zbeh interesimin dhe mundësinë e angazhimit të vazhdueshëm. Diskutimet në Kuvendet Komunale, përgjithësisht reflektojnë polarizimet partiake, e ngjashëm ndodh edhe me procesin e votimit.

Si rrjedhojë e kësaj, në fundin e mandatit 2017-2021, në shtatë (7) komuna (Gjakovë, Prizren, Suharekë, Malishevë, Vushtrri, Mitrovicë dhe Podujevë)⁸ nuk është arritur të sigurohet shumica, për votimin e buxhetit për vitin 2022 në afatin e paraparë (30 shtator) sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë, për rrjedhojë shumë procese e procedura janë shtyrë.

Kategorizimi i Komunave sipas numrit banorëve të reflektuar në numrin e anëtarëve

Në bazë të nenit 36 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVQL)⁹ numri i anëtarëve të Kuvendeve Komunale të Republikës së Kosovës ndahen në tetë (8) grupe referuar numrit të banorëve. Në grupin e parë përfshihen ato komuna që kanë më pak se 10.000 banorë me nga 15 anëtarë. Në këtë grup bëjnë pjesë tetë (8) komuna. Në grupin e dytë me më pak se 20.000 banorë e me 19 anëtarë në kuvend janë të listuara pesë (5) komuna. Ndërsa, në grupin e tretë, dy (2) komuna kanë rezultuar me më pak se 30.000 banorë e me 21 anëtarë të Kuvendit Komunal. Grupi i katërt përfshinë tetë (8) komuna me më pak se 50.000 banorë e me 27 anëtarë. Në anën tjetër, grupi i pestë mbanë gjashtë (6) komuna me më së shumti 70.000 banorë e 31 anëtarë. Grupi i gjashtë liston po ashtu gjashtë (6) komuna të cilat kanë më së shumti 35 anëtarë dhe 100.000 banorë. Vetëm dy (2) komuna janë pjesë e grupit të shtatë, i cili kushtëzon të ketë mbi 100.000 banorë dhe 41 anëtarë. Prishtina, e cila kategorizohet veçmas në grupin e tetë, rezulton me 51 anëtarë për shkak të statusit të saj si kryeqytet si dhe numrit të banorëve.

⁸https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/CommitteeMeetingDocumentFiles/Proc_nr_10_dt_30_03_2022_KBPT_Ar8bpSYE3f.pdf

⁹ [LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE \(rks-gov.net\)](#).

Në mënyrë që krahasimi në mes komunave të jetë sa më adekuat, është marrë ndarja e komunave sipas LVQL:

- I. Komunitet me deri në 10.000 banorë - 15 anëtarë;
- II. Komunitet me 10.001 deri 20.000 banorë - 19 anëtarë;
- III. Komunitet me 20.001 deri 30.000 banorë - 21 anëtarë;
- IV. Komunitet me 30.001 deri 50.000 banorë - 27 anëtarë;
- V. Komunitet me 50.001 deri 70.000 banorë - 31 anëtarë;
- VI. Komunitet me 70.001 deri 100.000 banorë - 35 anëtarë;
- VII. Komunitet mbi 100.000 banorë - 41 anëtarë;
- VIII. Kryeqyteti i Kosovës, Prishtina - 51 anëtarë.

Tabela e numrit të Këshilltarëve Komunal sipas numrit të banorëve

10,000 (15 anëtarë)	10,001- 20,000 (19 anëtarë)	20,001 - 30,000 (21 anëtarë)	30,001 - 50,000 (27 anëtarë)	50,001- 70,000 (31 anëtarë)	70,001-100,000 (35 anëtarë)	> 100,000 (41 anëtarë)	Prishtina (51 anëtarë)
Hani i Elezit	Zubin Potok	Obiliq	Kaçanik	Drenas	Gjakovë	Ferizaj	Prishtinë
Junik	Graçanicë	Shtime	Dragash	Suharekë	Podujevë	Prizren	
Novobërdë	Zveçan		Fushë Kosovë	Lipjan	Mitrovicë e Jugut		
Mamushë	Mitrovicë e Veriut		Kamenicë	Malishevë	Pejë		
Kllokot	Leposaviq		Istog	Rahovec	Gjilan		
Partesh			Klinë	Skenderaj	Vushtrri		
Shtërpcë			Viti				
Ranillug			Deçan				

Përfaqësimi i të rinjve në Kuvendet Komunale

Demokracia kërkon rol aktiv e pjesëmarrje të të gjithë qytetarëve në politikbërje dhe vendimmarrje. Përfaqësimi i të rinjve në vendimmarrjen komunale është një komponent i rëndësishëm në përfaqësimin e pikëpamjeve e interesave dhe pritjeve të këtij grupi shoqëror, që llogaritet të jetë afërsisht 1/4 e popullsisë. Një demokraci e konsoliduar merr parasysh pritjet, perspektivat dhe interesat e të gjitha shtresave shoqërore.

Kjo bëhet edhe më e rëndësishme, marrë parasysh edhe nevojën për energji të reja, inovacion dhe ndjekje të trendëve. Për ta bërë një demokraci sa më vibrante, ndërveprimi i moshave, përvojave, përkatësive (gjinore, etnike, fetare, kulturore), rritë diversitetin dhe multikulturalizimin e një vendi. Vetëm në zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2021, sipas të dhënave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, numri i votuesve të rinj, të cilët do të votojnë për herë të parë, është: **41 mijë e 12** votues, prej të cilëve **24 mijë e 697** kanë arritur moshën 18 vjeç pas datës 14 shkurt 2021 dhe **8 mijë e 937** votues të cilët mund të konsiderohet se janë regjistruar për herë të parë në regjistrin qendror civil pas zgjedhjeve të fundit parlamentare.¹⁰

Referuar të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), afër **23%**¹¹ të e popullsisë e përbëjnë grupmoshat **18-30 vjeç**. Kjo, siç duket reflektohet në proporcion të drejtë edhe në përfaqësim në Kuvendet Komunale të kësaj grupmoshe, ku nga të dhënat e siguruar del se **22.71%** e strukturave të Kuvendeve Komunale përbëhen nga këshilltarët e rinj nën moshën 30 vjeç.

Tabela me numra dhe përqindje të këshilltarëve komunalë nën moshën 30 vjeç

Nr.	Komuna	Numri i përgjithshëm i këshilltarëve të Kuvendeve Komunale	Mosha (nën 30)	% e këshilltarëve komunalë që janë nën moshën 30 vjeçare
1	Deçan	27	10	37.04%
2	Gjakovë	35	6	17.14%
3	Drenas	31	9	29.03%
4	Gjilan	35	7	20.00%
5	Dragash	27		
6	Istog	27	1	3.70%
7	Kaçanik	27	5	18.52%
8	Klinë	27	8	29.63%
9	Fushë Kosovë	27	6	22.22%

¹⁰ Të dhëna për listën përfundimtare të votuesve brenda dhe jashtë Kosovës – KQZ (kqz-ks.org)

¹¹ Popullsia e moshës 6 deri 29 vjeç sipas vijueshmërisë së shkollimit, gjinisë dhe viteve të vetme të moshës 2011. PxWeb (rks-gov.net)

10	Kamenicë	27	7	25.93%
11	Mitrovicë e Jugut	35	7	20.00%
12	Leposaviq	19		
13	Lipjan	31	6	19.35%
14	Novobërdë	15	3	20.00%
15	Obiliq	21	2	9.52%
16	Rahovec	31	11	35.48%
17	Pejë	35	2	5.71%
18	Podujevë	35	6	23.00%
19	Prishtinë	51	9	17.65%
20	Prizren	40	5	12.50%
21	Skenderaj	31	12	38.71%
22	Shtime	21	6	28.57%
23	Shtërpcë	15		
24	Suharekë	31	8	25.81%
25	Ferizaj	41	8	19.51%
26	Viti	27	8	29.63%
27	Vushtrri	35	8	22.86%
28	Zubin Potok	19		
29	Zvecan	19		
30	Malishevë	31	9	29.03%
31	Junik	15	8	53.33%
32	Mamushë	15	4	26.67%
33	Hani i Elezit	15	5	33.33%
34	Graçanicë	19		
35	Ranillug	15		
36	Partes	15		
37	Kllokot	15		
38	Mitrovicë e Veriut	19		

Nga ky segment, i cili merr për bazë 28 nga 38 komuna të Kosovës, mund të konstatojmë se pjesëmarrja e të rinjve (18-30 vjet) në kuvendet komunale është vetëm **22.71%**, apo **186 këshilltarë të rinj nga 819** të analizuar (me të dhëna). Në krahasim me grupmoshat e tjera, kjo pjesëmarrje del të jetë e fiksuar mes numrit të të rinjve dhe përfaqësimit. Megjithatë, disa komuna kanë arritur që në përbërjen e tyre të kenë më shumë këshilltarë të rinj në këtë grupmoshë, siç është rasti i Komunës së **Junikut**. Kjo komunë i prin listës me përqindjen më të lartë të këshilltarëve të rinj, ku **53.33%** e strukturës së saj është e përbërë nga këshilltarë nën moshën **30-vjeçare**.

Në anën tjetër, komuna me më së paku anëtarë të rinj është Istogu, ku vetëm 3.70% e kuvendit të saj përfshin të rinj (1 nga 27 këshilltarë). Kur i referohemi ndarjes së komunave në bazë të numrit të banorëve:

- **Grupin I** - përfshin komunat deri në 10,000 banorë, përqindjen më të lartë në këtë grup e ka Juniku, ashtu sikurse edhe në nivel vendi. Ndërsa, komuna me përqindjen më të vogël nga ky grup është Novobërda me vetëm tre (3) anëtarë të rinj nga 15 gjithsej, që i bie 20%.
- **Grupit II** - mungojnë të dhënat dhe nuk mund të konstatohen përqindjet e këtij faktori.
- **Grupin III** - përbehet nga komuna e Shtimes dhe Obiliqit: e para, rezulton të ketë përqindje më të lartë, me 28.57%, ndërsa e dyta, me vetëm 10% këshilltarë të rinj.
- **Grupin IV** - komuna me përqindjen më të lartë në këtë grup të anëtarëve të rinj është Deçani me 37.04 %. Në anën tjetër, komuna me përqindjen më të ulët është Istogu me 3.70%.
- **Grupi V** - komuna me përqindjen më të lartë të të rinjve është Skenderaj me 38.71%. Komuna me përqindjen më të ulët nga Grupi V është Lipjani me 19.35%.
- **Grupit VI** - përqindjen më të lartë e ka Vushtrria, ku 22.86% e Kuvendit Komunal. Ndërsa, Peja është komuna me përqindjen më të ulët të këtij grupi, ku vetëm 5.71% janë këshilltarë komunalë të rinj.
- **Grupin VII** - komuna e Ferizajt prin me 19.51%, kurse ajo me përqindjen më të vogël Prizreni me 12.50 % anëtarë të rinj në kuvendin e saj.
- **Kryeqyteti/Prishtina** - në rezultatet e nxjerra, nuk reflekton ndryshim të theksuar, krahasuar me komunat tjera. Në Kryeqytet nga 51 anëtarë, vetëm 9 janë nën moshën 30 vjeç apo 17.65%.

Përfaqësimi i këshilltarëve të Kuvendit Komunal me mandat të parë

Struktura e Kuvendeve Komunale përgjatë mandateve ka pësuar ndryshime të shumta. Disa nga anëtarët e Kuvendeve Komunale kanë ripërsëritur mandatin në disa legjislatura, e numri më i madh del të jenë anëtarë të Kuvendeve Komunale për herë të parë. Në 28 nga 38 komunat, ku janë mbledhur të dhënat, nga **819** këshilltarë komunalë, **502, apo 61.29%** kanë mandatin e parë.

Mandati si kategori në analizë reflekton ndryshimet në listat garuese, apo edhe prioritetet e qytetarëve ndaj kandidatëve për t'i përfaqësuar në vendimmarrje. Votuesit mund të kenë ndërruar preferencën politike apo emrat brenda listës zgjedhore. Potencialisht, kjo mund të ndikojë në ndryshimin e strukturës dhe në vendosjen e mandatarëve të rinj në Kuvendin Komunal. Ndryshimet mund të vijnë edhe nga mungesa e vullnetit të anëtarëve në procesin e ri-zgjedhjes, si rrjedhojë e pagesës së ulët apo edhe ngarkesës me përgjegjësi dhe detyra. Tërheqja nga kandidimi ka lënë hapësirë për politikbërës të rinj për të marrë mandat në Kuvendin Komunal.

Në tërësi, nëse i grupojmë të gjitha komunat, Malisheva ka rezultuar me më së shumti ndryshime në strukturën e këshilltarëve komunalë ndër mandate, me **74.19% anëtarë të rinj**. Ndërsa, në komunën e Novobërdës, vetëm **33.33%** e Kuvendit Komunal përbehet nga këshilltarë me mandat të parë. Kurse, sipas grupeve përkatëse në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, rezultatet vijojnë kështu:

- **Grupi I** - prin Hani i Elezit me 73.33% këshilltarë me mandat të parë. Ndërsa, me më së paku mandatarë të parë në këtë grup ka pasur komuna e Novobërdës, 33.33%.
- **Grupi II** - nuk kemi pasur qasje në informatat e këtyre komunave.
- **Grupi III**- ndarja është e barabartë mes Obiliqit dhe Shtimes me 57.14%
- **Grupi IV** - Deçani, Kamenica dhe Kaçaniku kanë rezultuar në përqindje të njëjtë me 74.07%. Ndërsa, më së paku në këtë grup ka dalë Fushë Kosova me 48.15%.
- **Grupi V** - Malisheva ka rezultuar me 74.19% siç edhe është lartpërmendur, dhe në të njëjtin grup Skenderaj me vetëm 51.61% ka pasur këshilltarë me mandat të parë.
- **Grupi VI** - 65.71% e Kuvendit Komunal në Pejë janë me mandat të ri, ndërsa Podujeva ka 45.71% mandatarë të parë.
- **Grupi VIII** - dallime mes dy komunave është, Prizreni me 60% dhe Ferizaj me 58.54%.
- **Kryeqyteti/Prishtina** - e cila veçohet për shkak të statusit si kryeqytet dhe në bazë të numrit të banorëve, ka këshilltarë me mandat të parë rreth 70.59%.

Tabelat me numra dhe përqindje e këshilltarëve që kanë marrë për herë të parë mandat të këshilltarit komunal

Nr.	Komuna	Numri i përgjithshëm i këshilltarëve të Kuvendeve Komunale	Numri i këshilltarëve që kanë mandatin e parë, nga të gjitha legjislaturat	% e këshilltarëve me mandat të parë
1	Deçan	27	20	74.07%
2	Gjakovë	35	25	71.43%
3	Drenas	31	22	70.97%
4	Gjilan	35	18	51.43%
5	Dragash	27		
6	Istog	27	12	44.44%
7	Kaçanik	27	20	74.07%
8	Klinë	27	16	59.26%
9	Fushë Kosovë	27	13	48.15%
10	Kamenicë	27	20	74.07%
11	Mitrovicë e Jugut	35	18	51.43%
12	Leposaviq	19		
13	Lipjan	31	21	67.74%
14	Novobërdë	15	5	33.33%
15	Obiliq	21	12	57.14%
16	Rahovec	31	22	70.97%
17	Pejë	35	23	65.71%

18	Podujevë	35	16	45.71%
19	Prishtinë	51	36	70.59%
20	Prizren	40	24	60.00%
21	Skenderaj	31	16	51.61%
22	Shtime	21	12	57.14%
23	Shtërpçë	15		
24	Suharekë	31	19	61.29%
25	Ferizaj	41	24	58.54%
26	Viti	27	16	59.26%
27	Vushtrri	35	19	54.29%
28	Zubin Potok	19		
29	Zveçan	19		
30	Malishevë	31	23	74.19%
31	Junik	15	10	66.67%
32	Mamushë	15	9	60.00%
33	Hani i Elezit	15	11	73.33%
34	Graçanicë	19		
35	Ranillug	15		
36	Partesh	15		
37	Klllokot	15		
38	Mitrovicë e Veriut	19		

Tabela krahasuese e ndryshimeve në mes dy legjislativave, në mes dy palë zgjedhjeve lokale 2017-2022

Referuar listës së kandidatëve nga KQZ, për zgjedhjet lokale të vitit 2017¹² dhe 2021 nga të dhënat e nxjerra në analizë mund të konstatojmë se nga 38 komuna, ndryshimi më i madh në përbërjen e kuvendit është në **Malishevë me 90.32%**, ku shumica e trupit të Kuvendit ka ndryshuar në këtë komunë. Ndërsa, më së paku ka ndryshuar struktura e kuvendit komunal në **Shtërpçë me vetëm 40.00%**. Kalkulimi i kësaj kategorie është bërë me pjesëtimin e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve për komunë me numrin e këshilltarëve të mandatit 2017 – 2021.

¹² <https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2018/03/1.Statistikat-sipas-komunave.pdf>

Nr.	Komuna	Numri i përgjithshëm i këshilltarëve të Kuvendeve Komunale	Ndryshimi në strukturën e Kuvendeve Komunale mes të mandateve 2017 dhe 2021	% e ndryshimit në strukturën e Kuvendeve Komunale mes të mandateve 2017 dhe 2021
1	Deçan	27	21	77.77%
2	Gjakovë	35	28	80.00%
3	Drenas	31	26	83.87%
4	Gjilan	35	24	68.57%
5	Dragash	27	19	70.37%
6	Istog	27	18	66.66%
7	Kaçanik	27	20	74.07%
8	Klinë	27	19	70.37%
9	Fushë Kosovë	27	18	66.66%
10	Kamenicë	27	22	81.48%
11	Mitrovicë e Jugut	35	27	77.41%
12	Leposaviq	19	14	73.68%
13	Lipjan	31	24	77.41%
14	Novobërdë	15	9	60.00%
15	Obiliq	21	18	85.71%
16	Rahovec	31	22	70.96%
17	Pejë	35	23	65.71%
18	Podujevë	35	30	85.71%
19	Prishtinë	51	43	84.31%
20	Prizren	40	34	82.92%
21	Skenderaj	31	24	77.41%
22	Shtime	21	16	76.19%
23	Shtërpçë	15	6	40.00%
24	Suharekë	31	21	67.74%
25	Ferizaj	41	28	68.29%
26	Viti	27	21	77.77%
27	Vushtrri	35	26	74.28%
28	Zubin Potok	19	12	63.15%
29	Zveçan	19	9	47.36%
30	Malishevë	31	28	90.32%
31	Junik	15	12	80.00%
32	Mamushë	15	8	53.33%
33	Hani i Elezit	15	11	73.33%
34	Graçanicë	19	14	73.68%
35	Ranillug	15	11	73.33%

36	Partesh	15	11	73.33%
37	Kllokot	15	13	86.66%
38	Mitrovicë e Veriut	19	11	57.89%

Përfaqësimi i grave në Kuvendin Komunal

Kosova ka arritur të ndërtojë legjislacion të avancuar që promovon dhe mbron barazinë gjinore. Megjithatë, gjendja në terren nuk e reflekton këtë mjaftueshëm, në veçanti tek përfaqësimi në pozita të larta publike, qofshin pozita politike, udhëheqëse, shërbim civil, shëndetësi, arsim. Këtu nuk bënë përjashtim as sektori privat. Përgjithësisht, kultura shoqërore priret t'u ofrojë grave më pak zë politik dhe më pak fuqi vendimmarrëse¹³.

Për shkak të mundësive të pakta të qasshmërisë së grave në politikbërje, legjislacioni ka vendosur mekanizma që mbrojnë dhe promovojnë barazinë. Pavarësisht se kuota gjinore nuk përfaqëson kërkesën e ligjit për barazi gjinore, ajo ka prodhuar efekte pozitive për fuqizimin e grave në politikbërje dhe vendimmarrje. Referuar Ligjit për Zgjedhjet Lokale, nenit 8 (Shpërndarja e vendeve në Kuvendin e Komunës), dhe specifikisht pikës 8.4, në rast kur përpjesëtimi i vendeve brenda subjekteve nuk e arrin kuotën e përfaqësimit gjinor 30%, atëherë kandidati i fundit i gjinisë shumicë zëvendësohet me atë të gjinisë pakicë. Pra, kjo, kryesisht reflektohet në rastet kur kuota mbetet nën 30%. Si p.sh dy (2) këshilltarë (1 burrë; 1 grua) në pesë (5) këshilltarë, ku kuota nuk kalon 20% atëherë i bie (3 burra; 2 gra) etj.¹⁴

Pas përpunimit të të dhënave të analizës për 38 Komunat e Kosovës, në total përfaqësimi i grave sipas përqindjes është **35,92%** apo nga **1002** këshilltarë komunalë **360** janë gra. Nëse i referohemi këtyre të dhënave, në total del se nga **1002** këshilltarë komunalë **203** gra apo **20.25%** kanë arritur të marrin mandatin me votë në garë me burrat. Nëse i përfshijmë edhe **27** gra brenda listave që kanë marrë mandate, në cilësinë e bartëseve të listës, apo 2.69%. Në total i bie **22.94%**. Ndërkaq, me kuotë kanë hyrë, **130** gra apo **12.97%**. Vetëm në një komunë (Kllokot) si rezultat del se vetëm një parti ka arritur të fitojë më shumë se mandatin e bartësit të listës, përfaqësimi i përgjithshëm është **26.67%**.

Tabela me numrin dhe përqindjen e grave në Kuvendin Komunal

Nr.	Komuna	Numri i këshilltarëve komunalë	Numri i këshilltarëve gra	% e këshilltarëve gra
1	Deçan	27	9	33.33
2	Gjakovë	35	13	37.14
3	Drenas	31	12	38.71
4	Gjilan	35	11	31.43

¹³ <https://kdi-kosova.org/programet/fuqizimi-i-gruas-ne-politike-dhe-vendimmarrje/>

¹⁴ http://infokomuna.com/m/sq/lajme/mucaj-kuota-gjinore-godet-aty-ku-se-pret?fbclid=IwAR1gB8A_BBS0xyU0kQvZ671i0Exhr_Yd20oyunvsa_4jAf7ECIOgByjXdoU

5	Dragash	27	10	37.04
6	Istog	27	10	37.04
7	Kaçanik	27	10	37.04
8	Klinë	27	11	40.74
9	Fushë Kosovë	27	8	29.63
10	Kamenicë	27	12	44.44
11	Mitrovicë e Jugut	35	12	34.29
12	Leposaviq	19	6	31.58
13	Lipjan	31	10	32.26
14	Novobërdë	15	6	40.00
15	Obiliq	21	9	42.86
16	Rahovec	31	11	35.48
17	Pejë	35	13	37.14
18	Podujevë	35	12	34.29
19	Prishtinë	51	17	33.33
20	Prizren	41	14	34.15
21	Skenderaj	31	11	35.48
22	Shtime	21	7	33.33
23	Shtërpcë	15	5	33.33
24	Suharekë	31	12	38.71
25	Ferizaj	41	17	41.46
26	Viti	27	10	37.04
27	Vushtrri	35	11	31.43
28	Zubin Potok	19	5	26.32
29	Zveçan	19	7	36.84
30	Malishevë	31	11	35.48
31	Junik	15	6	40.00
32	Mamushë	15	5	33.33
33	Hani i Elezit	15	6	40.00
34	Graçanicë	19	6	31.58
35	Ranillug	15	8	53.33
36	Partesh	15	6	40.00
37	Klllokot	15	4	26.67
38	Mitrovicë e Veriut	19	7	36.84

Tabela me numrin dhe përqindjen e grave që kanë marrë mandat me kuotën 30%; si dhe pa kuotë dhe bartëset e listës.

Nr.	Komuna	Numri i grave në Kuvendin Komunal	Numri i grave me kuotën 30%	Përqindja %	Numri i grave pa kuotë dhe bartëset e listës	% e këshilltarëve gra
-----	--------	-----------------------------------	-----------------------------	-------------	--	-----------------------

1	Deçan	9	5	55.6	4	44.44
2	Gjakovë	13	6	46.2	7	53.85
3	Drenas	12	7	58.3	5	41.67
4	Gjilan	11	4	36.4	7	63.64
5	Dragash	10	2	20.0	8	80.00
6	Istog	10	9	90.0	1	10.00
7	Kaçanik	10	1	10.0	9	90.00
8	Klinë	11	4	36.4	7	63.64
9	Fushë Kosovë	8	2	25.0	6	75.00
10	Kamenicë	12	5	41.7	7	58.33
11	Mitrovicë e Jugut	12	4	33.3	8	66.67
12	Leposaviq	6	1	16.7	5	83.33
13	Lipjan	10	5	50.0	5	50.00
14	Novobërdë	6	0	0.0	6	100.00
15	Obiliq	9	3	33.3	6	66.67
16	Rahovec	11	4	36.4	7	63.64
17	Pejë	13	4	30.8	9	69.23
18	Podujevë	12	5	41.7	7	58.33
19	Prishtinë	17	8	47.1	9	52.94
20	Prizren	14	10	71.4	4	28.57
21	Skenderaj	11	1	9.1	10	90.91
22	Shtime	7	2	28.6	5	71.43
23	Shtërpçë	5	0	0.0	5	100.00
24	Suharekë	12	5	41.7	7	58.33
25	Ferizaj	17	4	23.5	13	76.47
26	Viti	10	4	40.0	6	60.00
27	Vushtrri	11	3	27.3	8	72.73
28	Zubin Potok	5	0	0.0	5	100.00
29	Zveçan	7	2	28.6	5	71.43
30	Malishevë	11	7	63.6	4	36.36
31	Junik	6	1	16.7	5	83.33
32	Mamushë	5	5	100.0	0	0.00
33	Hani i Elezit	6	3	50.0	3	50.00
34	Graçanicë	6	1	16.7	5	83.33
35	Ranillug	8	0	0.0	8	100.00
36	Partes	6	0	0.0	6	100.00
37	Klllokot	4	2	50.0	2	50.00
38	Mitrovicë e Veriut	7	1	14.3	6	85.71

Në 5 nga 38 komuna, (Novobërdë, Shtërpçë, Zubin Potok, Partesh dhe Ranillug) 100% e grave kanë marrë mandatin pa kuotë dhe si bartëse liste. Këto komuna udhëhiqen nga komuniteti serb dhe dominon pushtetin vetëm një subjekt politik. Ndërkaq, përfaqësimi pa kuotë dhe bartëse liste është zero (0), në komunën e Mamushës.

Është e veçantë të theksohet se nga 642 burra që përfaqësohen në Kuvendet Komunale, vetëm një (1) ka hyrë me kuotën gjinore: në listën e PDK në Komunën e Fushë Kosovës, si rezultat se nga katër (4) këshilltarë të fituar tri (3) kanë qenë gra, apo 75%. Andaj, sipas Ligjit për Zgjedhjet Lokale, tek ndarja e mandateve, barazia gjinore nuk mund të mbetet nën 30%, si rezultat përfaqësimi është bërë 50/50.

Konkluzionet:

- Zgjedhjet Lokale, me lista të hapura, një votë, një kandidatë, paraqesin kredenciale të larta demokratike, ku qytetarët përzgjedhin kandidatin e preferuar për ti përfaqësuar interesat, e komuniteteve të tyre;
- Ndryshimi nga Rregullorja e UNMIK 2000/45 dhe 2007/30, me themelimin e degës ekzekutive në Komuna, ka adresuar problemin e ndryshimeve të shpeshta, bllokadave politike në Kuvende Komunale, megjithatë ka ulur mekanizmat e kontrollit mbi Kryetarin/Ekzekutivin, siç është rasti me raportin vjetor të punës. Ku tashmë, drejtorët/kryetari, paraqesin vetëm informatë para Kuvendit.
- Mungesa e praktikave, trupave të kuvendit dhe kultura politike jo mjaftueshëm e konsoliduar, në ndërmarrjen e iniciativave, ligjore, nga Kuvendi, apo ndikimit në prioritizimin e investimeve, ka zbehur rolin dhe nevojën e qytetarëve për adresim të problemeve; Mungesa e kapaciteteve, teknike, profesionale dhe financiare, mbështetëse, si dhe mos konsolidimi i trupave të Kuvendit (komiteteve profesionale; komiteteve konsultative; si dhe këshillave lokale), Kuvendin e ka kthyer në një rol formal të vendimmarrjes;
- Mungesa e hapësirave të punës për grupet politike; apo edhe trupat tjerë profesionalë, e kombinuar me mungesën e planifikimeve në buxhet për trajnime, mbështetje profesionale, praktika dhe modele, e ka forcuar gjuhën politike, dhe zbehur debatin profesional. Këtu, hyjnë edhe kompensimet e ulëta, që demotivojnë punën e këshilltarëve komunalë, dhe paraprakisht kandidimin e profesionistëve.
- Ndryshimi i strukturës së Kuvendeve Komunale, ku 61.29 %, nga 28 kuvende të analizuara, kanë marrë mandat për herë të parë, ka krijuar një hendek në njohjen e proceseve, kjo e kombinuar edhe me mungesë të programeve komunale për kapacitete. Në rrethanat, kur shumica e komunave, janë në projeksionet e planeve, strategjive dhe politikave afat-mesme dhe afat-gjata si: Korniza Afat-Mesme Buxhetore (3 vjeçare), Planet Zhvillimore Komunale, Hartat Zonale (8-10 vjeçare);

- Përkundër që përfaqësimi i të rinjve (18-30 vjeç), korrespondon me numrat real të kësaj moshe në shoqëri, në raportet kredibile theksohet se besueshmëria në përfaqësim mbetet e ulët. Në strategjinë për rininë (2019 – 2023) vetëm 10% e të rinjve besojnë se interesat e tyre janë të përfaqësuar ‘mirë’¹⁵.
- Përfaqësimi i grave në kuvendet komunale ende mbetet i varur nga kuota 30%, si rezultat i formulës së ndarjes së vendeve brenda subjekteve fituese/përfaqësimit gjinorë, 3.23% kalohet mbi kuota.
- Vetëm në një rast në Komunën e Fushë Kosovës, një burrë brenda një liste partiake, ka marrë mandat me kuota. Kjo, tregon se edhe brenda listave, gratë nuk arrijnë të kalojnë shumicën.
- Në llogaritjen e mandateve me kuota dhe pa kuota, del të ketë progres të theksuar, ku 20.25% e grave kanë fituar ‘vetë’ mandatet në garë me burrat, 12.97% kanë fituar bazuar në kuota. Nga listat fituese, 27 gra kanë qenë bartëse liste.

Rekomandimet:

- Në ndryshimet e propozuara ligjore të forcohen mekanizmat e kontrollit të Kuvendeve Komunale, mbi Ekzekutivin;
- Të forcohen kapacitetet teknike, profesionale dhe financiare, për inicim të nismave rregullative nga Kuvendet Komunale;
- Të themelohen/konsolidohen trupat e Kuvendit (komitetet profesionale dhe konsultative), për të rritur potencialin profesional dhe të përfshirjes;
- Komunitat të ofrojnë hapësira pune dhe pajisje për grupet politike dhe trupat e kuvendit;
- Të planifikohen programe për ngritjen e kapaciteteve, në veçanti për anëtarët me mandat të parë, si dhe përfshirjen e ekspertizës profesionale në punën e Kuvendeve Komunale;
- Në procesin e hartimit të Ligjit për Pagat, të sigurohen rritja e kompensimit për anëtarët e Kuvendeve Komunale, në mënyrë që të shtohen interesimi i profesionistëve për përfshirje dhe motivimi i anëtarëve aktual;

¹⁵ https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Strategjia_per_Rini-2019-2023.pdf

- Të forcohet roli i Kuvendit, duke u përfshirë direkt në fazat e hershme të përgatitjes së rregullativës, politikave, buxhetimit dhe dokumenteve strategjike, duke nisur nga procesi i konsultimit;
- Përgatitja e programeve të veçanta dhe mekanizmave, ku të rinjtë përfaqësojnë më drejtë nevojat, kërkesat dhe interesat e të rinjve; (grupet e këshilltarëve të rinj);
- Themelimi dhe konsolidimi i grupeve të grave, si dhe hartimi strategjive, planeve dhe agjendave për fuqizimin e grave.



Kosovo Local Government Institute
Address: Str. Egnatia, E-9, FI-3, Nr. 17, 10000
Prishtinë, Republic of Kosovo
Tel: +383 (0) 38 522 000
Mobile: +383 (0) 44 253 835
E-mail: info@klgi-ks.com | web: www.klgi-ks.com